

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 28 dhe nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 208/24 dhe 16/25), duke vepruar pas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga ORVAS shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për tregti, me seli në rr. Shën Leopold Mandiq 10, Dugopole, Republika e Kroacisë, nëpërmjet avokates Maja Pargovska nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 05.05.2025, mori

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin ORVAS shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për tregti, me seli në rr. Shën Leopold Mandiq 10, Dugopole, Republika e Kroacisë, do të fitojë kontroll mbi KANARIA d.o.o. për ofrim të shërbimeve të marinës, me seli në Put Vele Luke 10, Supetar (Qyteti Supetar), Republika e Kroacisë, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e rëndësishëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si pasojë e krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në **përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2. Parashtruesi i njoftimit për përqendrim detyrohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6,000.00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30,000.00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Arsyetim

Sipas nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në vijim: Ligji), më 16.04.2025, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në vijim: Komisioni) është dorëzuar njoftim për përqendrim nga ORVAS shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për tregti, me seli në rr. Shën Leopold Mandiq 10, Dugopolje, Republika e Kroacisë, me të cilin ORVAS do të fitojë kontroll mbi KANARIA d.o.o. për ofrim të shërbimeve të marinës, me seli në Put Vele Luke 10, Supetar, Republika e Kroacisë.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit që nga dita e pranimi të tij dhe, bazuar në të dhënat e dorëzuara në Njoftimin për Përqendrim dhe shtojcat përkatëse, përcaktoi sa vijon:

Veprimtaria themelore e ndërmarrjeve të përfshira:

- ORVAS, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për tregti, i nënshtrohet operimit (aktivitetit kryesor) – aktiviteteve të agjencive të udhëtimit dhe operatorëve turistikë. Kompania ORVAS me përgjegjësi të kufizuar për tregti është një kompani që është veçanërisht e angazhuar në

aktivitetet e agjencive turistike dhe operatorëve turistikë (e specializuar në shërbimet me qira të varkave me vela, anijeve motorike, katamaranëve, si dhe dhënien me qira të vilave turistike dhe akomodimin në hotele në ishujt e Hvar dhe Brac në Republikën e Kroacisë), dhe në një shkallë më të vogël, si aktivitet dytësor, me veprimtari bujqësore (plantacionet e veta të hardhisë dhe ullirit) për prodhimin e sasive të vogla të verës dhe vajit të ullirit të destinuara për shitje në kuadër të Grupit ORBIKO.

Shoqëria ORVAS me përgjegjësi të kufizuar për tregti është pjesë e Grupit ORBIKO dhe është 100% në pronësi të ORBIKO SHPK për tregtinë e Zagrebit. ORBIKO SHPK për tregtinë e Zagrebit, me seli në ul. Koturashka Cesta 69, Zagreb, Republika e Kroacisë është një kompani që është veçanërisht e angazhuar në tregtinë me shumicë dhe në të njëjtën kohë është përfaqësuese dhe distributore në territorin e Republikës së Kroacisë për një numër të madh markash duke filluar nga produktet e kujdesit dhe bukurisë, produkte ushqimore dhe jo ushqimore, pajisje teknike dhe elektrike, ilaçe, lodra, tekstile, cigare, vajra motorikë dhe shumë produkte të tjera.

Grupi ORBICO është i pranishëm edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes:

Shoqërisë për tregti dhe shërbime ORBICO SHPK Shkup, me seli në rr. Boris Trajkovski nr. 286, Komuna Kisella Vodë, 1000 Shkup, me aktivitet parësor tregti të pa specializuar me shumicë dhe është përfaqësues dhe distributor në territorin e Maqedonisë së Veriut për shumë marka ushqimore, vajra motorike, bateri, parfume, ujëra tualeti dhe deodorantë, kozmetikë dekorative, produkte për higjienë personale dhe mirëmbajtje banesash, etj.

-KANARIA d.o.o për ofrim të shërbimeve të marinës, ka si objekt veprimtarie aktivitetet e marinave. KANARIA d.o.o. vepron kryesisht në ofrimin e shërbimeve të marinave (shërbime nautike që përfshijnë transport detar dhe bregdetar, dhënie me qira të mjeteve lundruese, transport për nevoja të veta, shërbime të menaxhimit dhe ankorimit/lidhjes së mjeteve lundruese për turistë, mirëmbajtje dhe riparim të anijeve dhe mjeteve të tjera lundruese) në Kroaci, si dhe në një shkallë më të vogël, me shërbime dhënies me qira të hapësirave komerciale. KANARIA d.o.o. nuk ka shoqëri të varura ose të lidhura dhe i gjithë aktiviteti zhvillohet vetëm në territorin e Kroacisë.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Sipas nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE
Mr. Малинка Силјановска Николиќ